



# KARAKTERISTIKAT DHE SFIDAT E SIPËRMARRJEVE SOCIALE NË SHQIPËRI

*Studim krahasues*



## Në kuadër të



### **RISE-ALB**

Rafforzamento  
dell'Imprenditorialità  
Sociale in Albania

“Ky raport është përgatitur nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim me mbështetjen e Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim (AICS), në kuadër të projektit “RISE-ALB: Rafforzamento dell'Imprenditorialità Sociale in Albania” (AID 011864) zbatuar nga ENGIM Internazionale. Metodologjia e studimit është përgatitur në bashkëpunim me “ALTIS - Università Cattolica del Sacro Cuore (di Milano).

Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim. As institucionet dhe as organet e Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim dhe asnjë person që vepron në emër të tyre nuk ka përgjegjësi për përdorimin që mund t'i bëhet informacionit në këtë dokument.

©PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

TIRANË, SHQIPËRI 2023

**AUTORE:**

**ERILA HASKA  
ERA SHERIFAJ**

**GRAFIKA DHE FAQOSJA:**

**ENXHI REXHEPI**

# PARATHËNIE



Partnerët Shqipëri punon për zhvillimin e sipërmarrjes sociale (SS) përmes kërkimit dhe hulumtimit për të kuptuar më mirë karakteristikat dhe modelet e SS-ve, si dhe sfidat me të cilat ato përballen gjatë zhvillimit të tyre, duke synuar të edukojë të gjithë aktorët e ekosistemit të sipërmarrjes sociale për rëndësinë e mbështetjes të SS-ve, si një faktor i rëndësishëm për zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Këto instrumente janë në funksion të përpjekjeve advokuese për një mjedis mundësues institucional dhe financiar për SS-të.

Partnerët Shqipëri janë pioner, përse i përket studimeve dhe hulumtimeve në fushën e sipërmarrjes sociale, të cilat janë akoma në fazën fillestare. Disa nga studimet/punimet kryesore kërkimore janë:



Ky studim krahasues evidenton zhvillimet më të fundit dhe nevojat e sipërmarrjeve sociale, dhe do të shërbejë si kontribut për nisma të tjera në mbështetje të sipërmarrjeve sociale në Shqipëri, bazuar në rezultatet e projektit RISE-ALB. Qëllimi i projektit RISE-ALB është të përmirësojë përfshirjen socio-ekonomike të grupeve të pafavorizuara (veçanërisht grave, personave me aftësi të kufizuara dhe të rinjve që jetojnë në zonat rurale), kryesisht nëpërmjet forcimit të OSHC-ve lokale që mbrojnë të drejtat e tyre. Projekti mbështet zhvillimin e sipërmarrjes sociale, të identifikuar nga legjislati shqiptar në fuqi dhe praktikrat evropiane, si një instrument ideal për promovimin e Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) dhe punësimit të kategorive vulnerabël, në tre drejtime kryesore:

- Në nivel politiko-institucional, nëpërmjet trajnimeve dhe shkëmbimeve të praktikave të mira në lidhje me politikën dhe zhvillimit gjithëpërfshirës, për përfaqësuesit e autoriteteve kombëtare dhe vendore, dhe takimeve konsultative dhe tavolinave tekniko-institucionale për të diskutuar kuadrin ligjor dhe zbatimin e tij në praktikë.
- Në nivelin e shoqërisë civile, nëpërmjet trajnimeve dhe shkëmbimeve të praktikave të mira në Itali. Një skemë nën-grantimi u zhvillua për të financuar krijimin e deri në pesë sipërmarrjeve të reja sociale, të cilat u përfshin në programe të personalizuara trajnimi për fazën fillestare dhe ndërtimin e partneriteteve me subjektet fitimprurëse.
- Në nivel komuniteti, nëpërmjet kurseve të dedikuara të AFP-së, dhe aktiviteteve të punësimit për personat nga grupet e pafavorizuara në kuadrin e tre sipërmarrjeve sociale pilot në sektorët e pastërisë dhe agro-transformimit.

# TABELA E PËRMBAJTES

**02**

Parathënie

**05**

Tabela e Grafikëve

**05**

Tabela e Figurave

**06**

Terminologjia

**06**

Hyrje

**09**

Metodologjia

**11**

Karakteristikat e të Anketuarve

**15**

Gjetjet e Studimit

**15**

Karakteristikat e Sipërmarrjeve Sociale

**15**

Dimensioni Social

**21**

Dimensioni Ekonomik

**26**

Struktura e Qeverisjes

**26**

Sfidat dhe Nevojat e identifikuara nga  
Sipërmarrjet Sociale

**30**

Konkluzione

**34**

Rekomandime

**36**

Referenca

# TABELA E GRAFIKËVE

<b>Grafik 1:</b> Të anketuarit sipas formës ligjore të subjektit/entitetit ligjor (N=34) .....	11
<b>Grafik 2:</b> Të anketuarit sipas shpërndarjes gjeografike (N=34) .....	11
<b>Grafik 3:</b> Të anketuarit sipas vitit të themelimit të entitetit ligjor (N=33) .....	12
<b>Grafik 4:</b> Të anketuarit sipas vitit të themelimit të veprimtarisë së sipërmarrjes sociale (N=33) .....	13
<b>Grafik 5:</b> Të anketuarit sipas numrit të punonjësve me kohë të plotë dhe të pjesëshme (N=33) .....	13
<b>Grafik 6:</b> Të anketuarit sipas numrit të vullnetarëve (N=32) .....	14
<b>Grafik 7:</b> Numri i vullnetarëve sipas formës ligjore (N=34) .....	14
<b>Grafik 8:</b> Objektivat e ndjekura nga sipërmarrjet sociale të anketuara (N=34) .....	17
<b>Grafik 9:</b> Qëllimet që ndjekin sipërmarrjet sociale sipas formës së tyre ligjore (N=34) .....	17
<b>Grafik 10:</b> Lloji i strategjisë që përshkruan më mirë sipërmarrjet sociale (N=34) .....	17
<b>Grafik 11:</b> Lloji i strategjisë që përshkruan më mirë sipërmarrjet sociale sipas formës së tyre ligjore (N=34) .....	17
<b>Grafik 12:</b> Lloji i strategjisë që përshkruan më mirë sipërmarrjet sociale të krijuara dhe potenciale (N=34) .....	18
<b>Grafik 13:</b> Çështjet sociale të trajtuara nga sipërmarrjet sociale (N=34) .....	19
<b>Grafik 14:</b> Grupi më i shpeshtë i përfituesve të cilëve u shërbejnë sipërmarrjet sociale (N=34) .....	19
<b>Grafik 15:</b> Përqindja e grupeve të marginalizuara të punësuar nga sipërmarrjet sociale (N=32) .....	20
<b>Grafik 16:</b> Përqindja e grupeve të marginalizuara të punësuar nga sipërmarrjet sociale siaps formës së tyre ligjore .....	20
<b>Grafik 17:</b> Ndërmarrja e nismave specifike për mirëqënien e punonjësve (N=34) .....	21
<b>Grafik 18:</b> Industria në të cilën operojnë sipërmarrjet sociale ose dëshirojnë të operojnë (N=34).....	21
<b>Grafik 19:</b> Industria në të cilën operojnë sipërmarrjet sociale ose dëshirojnë të operojnë, sipas formës së tyre ligjore (N=34) .....	22
<b>Grafik 20:</b> Industria në të cilën operojnë sipërmarrjet sociale, ose dëshirojnë të operojnë sipas llojit të strategjisë së përdorur(N=34) .....	22
<b>Grafik 21:</b> Metodatat e prodhimit dhe/ apo sigurimit të shërbimeve që përshkruajnë më mirë aktivitetin e sipërmarrjes sociale sipas formës së tyre ligjore (N=34) .....	23
<b>Grafik 22:</b> Metodatat e prodhimit dhe/ apo sigurimit të shërbimeve që përshkruajnë më mirë aktivitetin e sipërmarrjes sociale sipas industrisë në të cilën ato operojnë(N=34) .....	23
<b>Grafik 23:</b> Burimet e të ardhurave e subjekteve fitimprurëse (N=6) .....	24
<b>Grafik 24:</b> Burimet e të ardhurave të organizatave jofitimprurëse (N=27) .....	25
<b>Grafik 25:</b> Format e shpërndarjes së fitimeve /të ardhurave (N=34) .....	25
<b>Grafik 26:</b> Përbërja e strukturës vendimmarrëse (N=34) .....	26
<b>Grafik 27:</b> Sfidat që pengojnë në rritjen e sipërmarrjeve sociale (N=34) .....	27
<b>Grafik 28:</b> Ndikimi i kuadrit ligjor aktual dhe trajtimit fiskal në zhvillimin e sipërmarrjeve sociale (N=34) .....	27
<b>Grafik 29:</b> Njohuria e pjesëmarrësve në studim mbi Kuadrin Ligjor të Ndërmarrjeve Sociale (N=33) .....	28
<b>Grafik 30:</b> Plani i sipërmarrjeve sociale për të aplikuar për statusin e Ndërmarrjes Sociale (N=32) .....	29
<b>Grafik 31:</b> Aplikimi për përfitimin e statusit të ndërmarrjes sociale sipas njohurive mbi kuadrin ligjor (N=30) .....	29

# TABELA E FIGURAVE

<b>Figura 1:</b> Të anketuarit sipas pozicionit të tyre në entitetin ligjor(N=34) .....	12
<b>Figura 2:</b> Kampioni sipas gjinisë së të anketuarve (N=34) .....	12
<b>Figura 3:</b> Të anketuarit sipas fazës së zhvillimit, krijimit ose jo të një sipërmarrje sociale (N=34) .....	12
<b>Figura 4:</b> Të anketuarit sipas statusit të ndërmarrjes sociale (N=34) .....	13
<b>Figura 5:</b> Opinioni personal i të anketuarve në lidhje me adresimin e sfidave sociale (N=34) .....	16
<b>Figura 6:</b> Opinioni personal i të anketuarve në lidhje me mundësinë për të marrë mbështetje nga të tjerët (N=34) .....	16
<b>Figura 7:</b> Aktivitetet në të cilat sipërmarrjet sociale bëjnë përpjekeje të nivelit të lartë për tu përfshirë (N=34) .....	24

## TERMINOLOGJIA

**Fundi i piramidës (Bottom of the pyramid)** - Kjo është një strategji e përdorur nga sipërmarrje sociale të cilat ofrojnë shërbime sociale, shëndetësore, dhe arsimore, të cilat mungojnë dhe nuk ofrohen as nga biznesi konvencional dhe as institucionet publike.

**Metoda e prodhimit me kapital intensiv** - Një metodë që kërkon më shumë pajisje dhe makineri për të prodhuar mallra/shërbime; domethënë kërkon një investim më të madh financiar.

**Sipërmarrja e tregtisë së ndershme** – Një sipërmarrje e cila vendos në plan të parë interesat e punëtorëve lokal, fermerëve dhe artizanëve dhe garanton pagesa të drejta përgjatë zinxhirit të furnizimit.

**Metoda e prodhimit me punë intensive** – Një metodë që kërkon një kontribut më të lartë të punës për të realizuar aktivitete prodhuese në krahasim me sasinë e kapitalit të nevojshëm.

**Sipërmarrje sociale me në fokus integrimin në punë** – Sipërmarrje sociale, misioni social i të cilave është integrimi i grupeve vulnerabël (psh. të papunët për një kohë të gjatë) në tregun e punës.

## HYRJE

**Sipërmarrjet sociale (SS)** janë variacione të sipërmarrjeve tradicionale që janë të orientuara drejt një misioni social. Në varësi të legjislacioneve të ndryshme, kulturës së biznesit, politikave dhe zhvillimit ekonomik, ekzistojnë përkufizime të ndryshme se çfarë është një sipërmarrje sociale. Megjithatë të gjitha takohen në një pikë se synimi kryesor i sipërmarrjeve sociale nuk është fitimi, por qëllimi social. Një element i rëndësishëm është se qëllimi social i një SS ndikohet nga kufizimi i mosshpërndarjes së fitimit. (Defourny & Nyssens, 2012).

Sipas përkufizimit të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OCED, 2022) një sipërmarrje sociale është “çdo veprimtari private që operon për interesin publik, e organizuar me një strategji sipërmarrëse, qëllimi kryesor i të cilës nuk është maksimizimi i fitimit por arritja e disa synimeve sociale dhe ekonomike dhe që ka kapacitetin për të sjellë ide novatore për zgjidhjen e problemeve të papunësisë dhe përjashtimit social” .

Për ta shpjeguar më saktë, Komisioni Evropian shton se fokusi është më shumë te impakti social sesa tek fitimi, i cili përdoret për të kontribuar për qëllimin social. Gjithashtu, menaxhimi është i hapur dhe gjithëpërfshirës midis punonjësve, konsumatorëve dhe aktorëve të interesit të cilët ndikohen nga aktiviteti tregtar i sipërmarrjes sociale. (Komisioni Evropian, 2017).

Sipërmarrja sociale po bëhet e njohur në shumë vende të botës, ndërkohë në Evropë të gjitha shtetet kanë zhvilluar në nivele të ndryshme kulturën dhe praktikën e sipërmarrjes sociale. Impakti i SS-së në ekonominë Evropiane vlen të studiohet sepse përafërsisht **13,6 milionë** Evropianë janë të punësuar nga sipërmarrjet sociale në të gjithë Evropën (Komisioni Evropian, 2020). Qëllimi social është i fokusuar kryesisht në ofrimin e mundësive të punësimit për grupet e pafavorizuara, ofrimin shërbimeve bazë të kujdesit, zgjidhjen e sfidave specifike të komunitetit, rritjen e gjithëpërfshirës, ofrimin e mundësive të barabarta, garantimin e qëndrueshmërisë dhe pjesëmarrjes qytetare ose arritjen e një ose disa prej qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm (Komisioni Evropian, 2020).

Bazuar në modelin e biznesit, shërbimet që ofrojnë, legjisllacionin, komunitetet për të cilat punojnë dhe shtetet ku janë pozicionuar, sipërmarrjet sociale mund të kategorizohen në grupe të ndryshme. Kuadri ligjor i vendeve të ndryshme Evropiane njihet 4 forma ligjore të SS-ve duke përfshirë: entitete jofitimprurëse të tilla si: shoqatat, fondacionet dhe institucionet; kooperativat; sipërmarrjet sociale ligjore që zakonisht karakterizohen nga ndryshime të njohura ligjorisht të formave ekzistuese juridike; shoqëri aksionare. Në bazë të modelit të biznesit dhe të qëllimit të tyre, SS-të kategorizohen në katër grupe kryesore (Komisioni Evropian, 2011).

1. **Shërbime sociale, shëndetësore dhe arsimore**, të cilat nuk ofrohen as nga biznesi konvencional dhe as institucionet publike.
2. **Integrimi në punë** i grupeve të marginalizuara;
3. **Zhvillimi lokal i zonave të pa favorizuara** përfshin sipërmarrjet sociale në zonat e largëta rurale, skemat e zhvillimit/rehabilitimi të lagjeve në zonat urbane, ndihma për zhvillim, dhe bashkëpunim për zhvillim me vendet e treta;
4. **Të tjerët** angazhohen në ofrimin e produkteve/shërbimeve të ndryshme (**riciklimi, mbrojtja e mjedisit, sporti, arti, kultura ose ruajtja historike, shkenca, hulumtim dhe inovacion, mbrojtja e konsumatorit dhe sportet amatore**) duke përdorur përfaqshen e **inovacionit social**.

Integrimi në punë është forma më e përhapur dhe më e zhvilluar e sipërmarrjes sociale në Evropë (Komisioni Evropian, 2015) dhe kjo ndodh kryesisht për shkak të problemeve me papunësinë, veçanërisht me normat e larta të papunësisë së të rinjve.

SS-të në Evropë shfaqin karakteristika të ndryshme dhe përfitojnë mbështetje nga qeveria, e cila ndryshon nga një vend në tjetrin. Për shembull në rastin e Italisë, “kontratat dhe/ose marrëveshjet me institucionet publike garantojnë afërsisht **70%** e të ardhurave të tipit A dhe sipërmarrjeve sociale miks, dhe **57.1 %** e të ardhurave për tipin B. Ndërsa në Greqi shuma shkon në **65%** (Borzaga, C., Poledrini, S., & Galera, G., 2017). Në Itali anëtarësimi gjithashtu është i rregulluar ligjërisht, dhe kooperativat sociale lejohen të pranojnë anëtarë vullnetarë në nivelin **50%** të pjesëmarrjes totale të anëtarëve (Traversi, 2019).

Siç u përmend më herët në raport, qasja ndaj fitimit është një nga shtyllat kryesore që dallon sipërmarrjet sociale nga ato tradicionale. Gjithashtu, kjo qasje dallon SS-të nga një vend në tjetrin. Për shembull në **Itali**, deri në **50%** e fitimit mund të shpërndahet në këto drejtime: rritja e kapitalit; angazhim për organizatat e segmentit të tretë; shpërndarja e fitimit me aksionerët/anëtarët e sipërmarrjes sociale (Salatino, 2018). Në **Kroaci 75%** e fitimit duhet të riinvestohet nga sipërmarrja sociale për avancimin e veprimtarisë dhe për përmbushjen e misionit të saj social (Komisioni Evropian, 2014). Në **Greqi**, ligjërisht **60%** e fitimit duhet të riinvestohet brenda kompanisë për punësime shtesë, **35%** si shpërblim produktiviteti për punonjësit dhe **5%** duhet të mbahet si fond rezervë (Komisioni Evropian, 2014).

Duke qenë se tipologjia e tyre është e ndryshme nga sipërmarrjet tradicionale dhe përdorimi i fitimit nuk është i dedikuar 100% për aksionerët, sfidat e sipërmarrjeve sociale vijnë nga spektra të ndryshëm.

Disa nga sfidat më të zakonshme të SS-ve lidhen me aftësinë për tu vetë-organizuar, njohjen dhe vizibilitetin, aksesin në burime, hulumtimin, edukimin dhe zhvillimin e aftësive (Komisioni Evropian, 2020). Megjithatë, të gjithë studiuesit bien dakord që sfida kryesore e cila qëndron mbi të gjitha dhe vazhdon të jetë njëkohësisht sfida dhe nevojë është **aksesi në fonde**. Pavarësisht nevojës emergjente të sipërmarrjeve sociale për financim, vetëm **36%** e anëtarëve të rrjetit Euclid në Evropë mbështesin sipërmarrjet sociale me fonde ose ndihmë financiare (Rjeti Euclid, 2021).



Shqipëria, një nga gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor dhe pjesë e rajonit të Mesdheut është një treg i vogël evropian në zhvillim, i cili është i fokusuar drejt zhvillimit teknologjik së bashku me një ekonomi në rritje. Në Shqipëri ka novatorë të rinjë potencialë, që me disa përpjekje të përqendruara duke përfshirë këtu ofrimin e kapitalit fillestar dhe mentorimin e duhur, mund të krijojnë një propozim tregu me vlerë. Megjithatë iniciativat në fushën e sipërmarrjes sociale vazhdojnë të jenë shumë të vogla. Nisur nga përkufizimi i BE-së për SS-të, sipërmarrjet sociale në Shqipëri operojnë nën këto forma ligjore: subjekt fitimprurës (biznes, person fizik/juridik), organizatë jo-fitimprurëse, kooperativë. Sipërmarrësit socialë shqiptarë që morën pjesë në studimin e kryer nga Partnerët Shqipëri në vitin 2020, kanë deklaruar se tre janë sfidat kryesore që kanë penguar rritjen SS-ve të tyre: **mungesa e financimit, ndërgjegjësimi i ulët i klientëve dhe ndërgjegjësimi i ulët i investitorëve** (Partnerët Shqipëri, 2020). Ndërsa katër shtyllat kryesore në të cilat sipërmarrësit socialë në Shqipëri përqendrojnë përpjekjet për të rritur bizneset e tyre janë: **organizimi i aktiviteteve, trajnimi, edukimi dhe rrjetëzimi**. Ata përqendrojnë 52,4% - 59,5% të përpjekjeve në secilën prej këtyre aktiviteteve (Partnerët Shqipëri, 2020).

Në Shqipëri ligji **Nr.65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”** u miratua nga kuvendi në 2016, dhe hyri në fuqi në vitin 2019 për shkak të vonësive në plotësimin e kuadrit ligjor me të gjitha aktet nënligjore. Sipas ligjit vetëm organizatat jo-fitimprurëse mund të përfitojnë statusin e ndërmarrjes sociale. Që nga 2019, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale në Shqipëri ka hapur thirrjen për aplikim për përfitimin e statusit të ndërmarrjes sociale (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, 2019). Deri në prill 2022, vetëm 13 organizata kanë aplikuar për statusin e NS-së dhe 9 prej tyre e kanë përfituar statusin, ndërsa 4 janë refuzuar (Partners Albania, 2022).

Përsa i përket mbështetjes nga qeveria përmes programeve të dedikuara financuese, në vitin 2018 është krijuar fondi në mbështetje të ndërmarrjeve sociale për periudhën 2019-2021, me një vlerë totale 249 760 000 (dyqind e dyzet e nëntë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë. Në përfundim të procesit të aplikimit për mbështetje financiare nga fondi, asnjë nga aplikimet e sipërmarrjeve sociale nuk u përzgjedh për financim (Partnerët Shqipëri, 2022).

# METODOLOGJIA

Qëllimi i këtij studimi është që të ofrojë një hartëzim të sipërmarrjeve sociale “të themeluara dhe potenciale” në Shqipëri dhe të kuptojë më mirë karakteristikat e tyre, nevojat dhe tendencat e sektorit në të ardhmen. Gjithashtu, duke qenë se ky është studimi i dytë në të njëjtin këndvështrim dhe qëllim, synimi i tij është të krahasojë rezultatet me ato të studimit të kryer në vitin 2020, për të identifikuar ndryshimet kryesore dhe progresin e sipërmarrjeve sociale në Shqipëri. Metodologjia është përgatitur në bashkëpunim me “ALTIS - Università Cattolica del Sacro Cuore (di Milano).

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e studimit bazohet në metodën përshkruese përmes mbledhjes së të dhënave parësore duke përdorur një pyetësor gjysmë të strukturuar dhe mbledhjes së të dhënave dytësore nga raporte dhe studime e mëparshme, të kryera në vend dhe më gjerë. Për përzgjedhjen e të anketuarve është përdorur një data bazë e sipërmarrjeve sociale de-facto, e cila përfshin edhe organizatat që kanë përfitur statusin e ndërmarrjes sociale, sipas ligjit Nr.65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë” (Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, 2016). Data baza e sipërmarrjeve sociale është një burim i brendshëm i Partnerëve Shqipëri, e ndërtuar mbi eksperiencën e punës me sipërmarrjet sociale dhe organizatat jo-fitimprurëse. Kriteri kryesor i përdorur për përzgjedhjen e të anketuarve është përfshirja e sipërmarrjeve sociale ashtu edhe ideve të sipërmarrjes sociale, me synim vlerësimin e tendencave dhe shërbimeve/produkteve të mundshme, të cilat mund të shërbejnë si input për nisma të tjera në mbështetje të sipërmarrjeve sociale në Shqipëri, bazuar në rezultatet e projektit RISE-ALB. Bazuar në përkufizimin e BE-së për sipërmarrjet sociale, studimi përfshin sipërmarrje sociale në dy forma kryesore ligjore (organizata jofitimprurëse, dhe subjekte fitimprurëse) dhe gjithë format e tjera janë vendosur nën kategorinë “të tjera”. Pyetësori është shpërndarë gjithsej me 77 sipërmarrje sociale të themeluara dhe ide të sipërmarrjes sociale, dhe shkalla e përgjigjeve të anketës ishte 44% (34). 21 organizata ose 62% e pjesëmarrësve në studim kanë marrë pjesë edhe në studimin e vitit 2020. Pyetësori është vetë-administruar nga të anketuarit duke përdorur një mjet online (Lizmo Survey), për mbledhjen e të dhënave.

Partnerët Shqipëri realizoi mbledhjen e të dhënave gjatë periudhës korrik – shtator 2022. Ky proces u zhvillua në dy faza: a) Shpërndarja e pyetësorit online tek kampioni i përzgjedhur; b) Komunikimi në telefon me të anketuarit (vetëm në rastet kur ishte e nevojshme) për të vlerësuar saktësinë dhe vlefshmërinë e të dhënave të mbledhura nëpërmjet pyetësorit. Analiza e të dhënave është kryer me Programet SPSS dhe Excel.

Pyetjet kërkimore, mbi të cilat bazohet studimi janë:

1. Cilat janë karakteristikat kryesore të sipërmarrjeve sociale për sa i përket shërbimeve/produkteve, aktiviteteve, përfituesve, punonjësve, grupeve të klientëve, qëllimet?
2. Cilat janë strategjitë kryesore, metodat e prodhimit/shërbimit të përdorura nga sipërmarrjet sociale?
3. Si e sigurojnë sipërmarrjet sociale qeverisjen me pjesëmarrje, në aspektin e përfshirjes të aktorëve të ndryshëm dhe shpërndarjen e fitimit?
4. Cilat janë burimet kryesore e të ardhurave?
5. Si i nxisin sipërmarrjet sociale punonjësit në veçanti ata që u përkasin grupeve të marginalizuara?
6. Cilat janë sfidat me të cilat përballen sipërmarrjet sociale dhe cilat janë aftësitë që ato konsiderojnë të nevojshme për tu zhvilluar/ përmirësuar?
7. Cili është niveli i njohurive dhe qëndrimi i sipërmarrjeve sociale mbi kuadrin ligjor “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”?
8. A ka ndryshim midis sipërmarrjeve sociale të krijuara dhe atyre potenciale për sa i përket karakteristikave, industrisë, strategjisë dhe qëllimit?
9. A ka ndryshim midis formave ligjore të SS-ve për sa i përket karakteristikave, industrisë, strategjisë, qëllimit, burimet e të ardhurave, strukturës së qeverisjes dhe shpërndarjes së fitimit?

Pyetësi u bazua në pyetjet kërkimore të sipërpërmendura, dhe mbledhi informacion në lidhje me:

- Informacion të përgjithshëm për sipërmarrjet sociale të themeluara dhe potenciale: përfaqësuesit, viti i themelimit, forma ligjore, numri i punonjësve dhe vullnetarëve.
- Informacion mbi dimensionin social dhe ekonomik të sipërmarrjeve sociale: opinioni personal për zgjidhjen e problemeve sociale, synimet, metodat e prodhimit/shërbimit, strategjitë, produktet/shërbimet, llojet e përfituesve, klientët, aktivitetet, burimet e të ardhurave.
- Informacion mbi strukturën qeverisëse të sipërmarrjeve sociale: kategoritë e anëtarëve të përfshirë në vendimmarrje, shpërndarjen e fitimit; trajtimin e punonjësve.
- Informacion mbi sfidat me të cilat përballen dhe aftësitë që sipërmarrjet sociale duhet të zhvillojnë.
- Informacion mbi nivelin e njohurive ndaj kuadrit ligjor, trajtimit tatimor, interesit për përfitimin e statusit.

Gjetjet e paraqitura në këtë raport janë në formën e frekuencës dhe vlerave të kryqëzuara. Variablat kryesore të zgjedhura për vlerat e kryqëzuara janë: (a) SS-të e themeluara kundrejt SS-ve potenciale, (b) forma ligjore, (c) industria dhe (d) strategjia.

Çdo grafik tregon numrin total të përgjigjeve. Për disa pyetje, madhësia e kampionit është më e vogël në numër, për shkak të numrit të përgjigjeve të marra nga sipërmarrjet sociale ose për shkak të analizave të thella brenda kampionit.

# KARAKTERISTIKAT E TË ANKETUARVE


Në këtë pjesë janë paraqitur të dhënat kryesore të pjesëmarrësve në studim.

GRAFIK 1: TË ANKETUARIT SIPAS FORMËS LIGJORE TË SUBJEKTIT/ENTITETIT LIGJOR (N=34)




Rezultatet e studimit tregojnë se 82.4% e pjesëmarrësve në studim operojnë si organizata jo-fitimprurëse, ndërsa pjesa tjetër janë të regjistruara si subjekte fitimprurëse. Vihet re se ndryshe nga studimi i 2020, (ku morën pjesë 3 kooperativa, nga 42 SS), në vitin 2022 nuk ka SS që i përkasin kategorisë “kooperativë”. Ata u kontaktuan por nuk iu përgjigjën anketës.

GRAFIK 2: TË ANKETUARIT SIPAS SHPËRNDARJES GJEOGRAFIKE (N=34)




Shumica e ideve dhe sipërmarrjeve sociale që morën pjesë në studim janë të pozicionuara në Tiranë (52.9%), dhe në Shkodër (11.8%), sepse organizatat jofitimprurëse më aktive janë të përqendruara në këto qytete. Shpërndarja gjeografike ka pothuajse të njëjtat karakteristika si në vitin 2020.

FIGURA 1: TË ANKETUARIT SIPAS POZICIONIT TË TYRE NË ENTITETIN LIGJOR(N=34)




Shumica e pjesëmarrësve në studim (58.8%) kanë pozita drejtuese në entitetet e tyre, si drejtorë ekzekutivë ose si themelues. Pjesa tjetër e të anketuarve janë punonjës, menaxherë, pronar, vullnetar ose në pozita të tjera brenda SS-së.

FIGURA 2: KAMPIONI SIPAS GJINISË SË TË ANKETUARVE (N=34)




Pjesëmarrësit në studim janë 67.6% femra dhe 32.4% meshkuj.

FIGURA 3: TË ANKETUARIT SIPAS FAZËS SË ZHVILLIMIT, KRIJIMIT OSE JO TË NJË SIPËRMARRJE SOCIALE (N=34)




Nga entitetet pjesëmarrëse në studim **73.5%** e tyre kanë aktivitet të sipërmarrjes sociale. Pjesa tjetër janë ende në fazën e ideve të sipërmarrjes sociale. Statistikat janë të ngjashme me studimin e vitit 2020.

GRAFIK 3: TË ANKETUARIT SIPAS VITIT TË THEMELIMIT TË ENTITETIT LIGJOR (N=33)




Nga gjetjet rezultojn se pjesa më e madhe e entiteteve (72.7%) janë themeluar në dekadën e fundit, gjatë periudhës 2011-2022. 21,2% e tyre, janë themeluar gjatë viteve 2001-2010 dhe vetëm 6,1% janë më të vjetrat, të themeluara gjatë periudhës 1990-2000.

GRAFIK 4: TË ANKETUARIT SIPAS VITIT TË THEMELIMIT TË VEPRIMTARISË SË SIPËRMARRJES SOCIALE (N=33)




Nga organizatat të cilat kanë marrë pjesë në studim, 57.6% kanë themeluar sipërmarrjet e tyre gjatë viteve 2016-2022, dhe 15.2% e tyre gjatë periudhës 2011-2015. Organizatat e tjera nuk kanë ngritur ende një aktivitet të sipërmarrjes sociale.

FIGURA 4: TË ANKETUARIT SIPAS STATUSIT TË NDËRMARRJES SOCIALE (N=34)




GRAFIK 5: TË ANKETUARIT SIPAS NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KOHË TË PLOTË DHE TË PJESSHME (N=33)



Përafërsisht tre të katërtat e organizatave që kanë marrë pjesë në studim (75.8%) kanë një numër relativisht të ulët të punonjësve me kohë të plotë nga 1 deri në 5. Në vitin 2020, 38% e organizatave kishin punësuar më shumë se 5 punonjës me kohë të plotë. Ndërsa, në vitin 2022 ky numër është më i ulët në 24.3%. COVID-19 mund të konsiderohet si një nga arsyet e mundshme, e cila ka ndikuar negativisht në rritjen dhe zhvillimin e sipërmarrjeve sociale.


Përsa i përket punonjësve me kohë të pjesshme, shumica e organizatave që ishin pjesë e studimit (56.3%) punësojnë nga 1 deri në 5 punonjës me kohë të pjesshme. Sipërmarrjet sociale që punësojnë 6 deri në 10 punonjës përbëjnë 21.9% të kampionit të studimit, ndërsa 15.6% e kampionit nuk punësojnë asnjë punonjës me kohë të pjesshme.

**GRAFIK 6: TË ANKETUARIT SIPAS NUMRIT TË VULLNETARËVE (N=32)**



Shumica e pjesëmarrësve në studim (59.4%) kanë 1-10 vullnetarë, ndjekur nga 25% që kanë më shumë se 11 vullnetarë dhe 15.6% që nuk përfshijnë vullnetarë.

**GRAFIK 7: NUMRI I VULLNETARËVE SIPAS FORMËS LIGJORE (N=34)**



Të dy format ligjore të entiteteve, jo-fitimprurëse dhe fitimprurëse, karakterizohen nga një numër prej 1-10 vullnetarësh. Për organizatat fitimprurëse (80% e tyre), grupi 1-10 vullnetarë është më i përzgjedhuri, ndërsa organizatat jo-fitimprurëse kanë një shpërndarje ndryshe, por përfshirja e 1-10 vullnetarë vazhdon të jetë më e shpeshta edhe për to, 53.6% e tyre. Megjithatë, të dhënat tregojnë qartë se organizatat jo-fitimprurëse përfshijnë shumë më tepër vullnetarë sesa subjektet fitimprurëse.

# GJETJET E STUDIMIT

Karakteristikat e sipërmarrjeve sociale mund ti përshkruajmë nëpërmjet tre shtyllave kryesore, të cilat janë të lidhura me perspektivën ekonomike, sociale dhe strukturën qeverisëse. Në këtë seksion, bazuar në rezultatet e studimit, janë paraqitur karakteristikat e SS-ve të kategorizuara sipas këtyre dimensioneve. Gjithashtu, janë paraqitur sfidat dhe nevojat e SS-ve dhe qëndrimi i tyre ndaj kuadrit ligjor dhe trajtimit tatimor.

## KARAKTERISTIKAT E SIPËRMARRJEVE SOCIALE BAZUAR NË TRE PARIMET KRYESORE


Më poshtë janë paraqitur gjetjet në lidhje me dimensionin social, ekonomik dhe strukturën e qeverisjes.

### DIMENSIONI SOCIAL

Kjo shtyllë fokusohet në të gjitha karakteristikat sociale të entiteteve, duke përfshirë qëllimin, strategjitë, çështjet e trajtuara, përfituesit e synuar, grupet e marginalizuara të punësuar, nismat për mirëqenien e punonjësve, si dhe opinionet personale në lidhje me impaktin që SS-të mund të kenë në shoqëri, dhe mbështetjen që ata mund të marrin nga publiku.




FIGURA 5: OPINIONI PERSONAL I TË ANKETARVE NË LIDHJE ME ADRESIMIN E SFIDAVE SOCIALE (N=34)




Shumica e të anketuarve (94%) ndihen **pozitivë** kur bëhet fjalë për kontributin e tyre për adresimin e sfidave sociale dhe gjetjen e mënyrave për ta bërë këtë. Gjithashtu, **68%** e të anketuarve besojnë se ata mund të sjellin një ndryshim të rëndësishëm shoqëror, ndërsa 33% nuk janë dakord ose kanë një qëndrim neutral, përsa i përket mundësisë për të sjellë një ndryshim të rëndësishëm shoqëror. Këto përqindje janë pothuajse të njëjta me ato të vitit 2020, duke treguar se njerëzit e angazhuar në sipërmarrjet sociale janë optimistë dhe besojnë se mund të sjellin ndryshime pozitive në shoqëri. Përqindja e të anketuarve që mendojnë se mund të gjejnë një mënyrë që kontribuon në zgjidhjen e problemeve me të cilat përballlet shoqëria është **6%** më e ulët se viti 2020.

FIGURA 6: OPINIONI PERSONAL I TË ANKETUARVE NË LIDHJE ME MUNDËSINË PËR TË MARRË MBËSHTETJE NGA TË TJERËT (N=34)




Edhe pse më shumë se 50% e të anketuarve besojnë se është e mundur tërheqja e investitorëve dhe sigurimi i mbështetjes për të kontribuar në zgjidhjen e problemeve sociale, besimi i sipërmarrësve socialë shqiptarë ndaj investitorëve dhe komunitetit mbështetës është ulur ndjeshëm. Shumica e pjesëmarrësve në studim (62%) mendojnë se është e mundur të tërheqësh investitorë për një sipërmarrje sociale që ofron zgjidhje për problemet sociale, por kjo përqindje është më e ulët krahasuar me vitin 2020 (83.5%). Në të njëjtën linjë, 56% e të anketuarve mendojnë se njerëzit do t'i mbështesnin nëse planifikojnë të adresojnë një problem të rëndësishëm shoqëror, krahasuar me 81% në 2020.

GRAFIK 8: QËLLIMET QË NDJEKIN SIPËRMARRJET SOCIALE E ANKETUARA (N=34)



Shumica e pjesëmarrësve në studim (62%) deklaruan se SS-të e tyre ndjekin kryesisht **qëllimin social** dhe jo atë ekonomik. 20% e SS-ve ndjekin qëllimin ekonomik dhe 18% e tyre ndjekin qëllimi social dhe ekonomik në të njëjtin nivel. Krahasuar me vitin 2020, vihet re një rënie në përqindje e SS-ve që ndjekin të dy, qëllimin social dhe ekonomik (nga 33% në 2020 në 18% në 2022), duke sjellë një rritje të përqindjes respektivisht në dy kategoritë e tjera.


**GRAFIK 9: QËLLIMET QË NDJEKIN SIPËRMARRJET SOCIALE SIPAS FORMËS SË TYRE LIGJORE (N=34)**



Ekziston një ndryshim midis qëllimeve të ndjekura nga organizatat fitimprurëse dhe organizatat jo-fitimprurëse. Vihet re një rritje e dukshme e fokusit të subjekteve fitimprurëse drejt qëllimit social. 50% e organizatave fitimprurëse ndjekin qëllimin ekonomik, krahasuar me 71% në 2020, dhe 33.3% ndjekin qëllimin social dhe ekonomik në të njëjtin nivel, krahasuar me vetëm 14% të tyre në 2020. Përqindja e sipërmarrjeve sociale të krijuara nga organizatat jo-fitimprurëse që ndjekin qëllimin social është rritur nga 63% në 2020 në 71.4% në 2022, dhe përqindja e atyre që ndjekin qëllimin ekonomik është rritur nga 0% në 2020 në 14.3% në 2022.

**GRAFIK 10: LLOJI I STRATEGJISË QË PËRSHKRUAN MË MIRË SIPËRMARRJET SOCIALE (N=34)**


■ Sipërmarrje sociale me në fokus integrimin në punë (56%)
 ■ Sipërmarrje e tregtisë së ndershme (20%)
 ■ Tjetër (15%)
 ■ Sipërmarrje sociale me fokus ofrimin e shërbimeve (Fundi i piramidës) (9%)



Rezultatet tregojnë se **integrimi në punë** i grupeve të marginalizuara vazhdon të jetë strategjia kryesore e përdorur nga SS-të pjesëmarrëse në studim. Numri i SS-ve që përdornin këtë strategji në vitin 2020 përfaqësonte vetëm 40% të SS-ve pjesëmarrëse në studim, ndërsa në vitin 2022 përfaqëson 56% e tyre.


Strategjia e dytë më e përdorur është **sipërmarrja e tregtisë së ndershme**, e cila vendos në plan të parë interesat e punëtorëve lokal, fermerëve dhe artizanëve dhe garanton pagesa të drejta përgjatë zinxhirit të furnizimit. Ndërsa, strategjia “fundi i piramidës” e cila konsiston në ofrimin e shërbimeve sociale për një grup të caktuar klientësh, përdoret më pak nga SS-të. Vetëm 9% e tyre e kanë zgjedhur atë, krahasuar me 24% në 2020. Kjo mund të shpjegohet me ndryshimet në kampion, si dhe me ndryshimet e mundshme në fokusin dhe orientimin e disa organizatave.

**GRAFIK 11: LLOJI I STRATEGJISË QË PËRSHKRUAN MË MIRË SIPËRMARRJET SOCIALE SIPAS FORMËS SË TYRE LIGJORE (N=34)**



Vihet re një rritje në korrelacionin midis organizatave jo-fitimprurëse dhe strategjisë së integritit në punë nga njëra anë dhe korrelacionit midis subjekteve fitimprurëse dhe strategjisë së tregtisë së ndershme nga ana tjetër. Në këtë kontekst 66,7% e subjekteve fitimprurëse janë të fokusuar në strategjinë e tregtisë së ndershme, krahasuar me 57% në vitin 2020 dhe 64,3% e organizatave jo-fitimprurëse janë të fokusuar në strategjinë sociale të integritit në punë, krahasuar me 44% në 2020.


**GRAFIK 12: LLOJI I STRATEGJISË QË PËRSHKRUAN MË MIRË SIPËRMARRJET SOCIALE TË THEMELUARA DHE POTENCIALE (N=34)**



Nuk ka asnjë ndryshim midis SS-ve të krijuara dhe atyre të mundshme për sa i përket strategjisë kryesore të përdorur prej tyre. Shumica e SS-ve janë të fokusuar në **integrimin në punë** të grupeve të marginalizuara. SS-të e themeluara zgjedhin tregtinë e ndershme si alternativë të dytë, ndërsa SS-të e mundshme përpiqen të gjejnë strategji të tjera të ndryshme.


Por në krahasim me vitin 2020, ka ndryshime të rëndësishme, veçanërisht për SS-të e mundshme. Shumica prej tyre zgjedhën si strategji kryesore sipërmarrjen e tregtisë së ndershme dhe fundin e piramidës (përkatesisht 37.5%), ndërsa integrimi në punë u zgjodh vetëm nga 12% e tyre.

GRAFIK 13: ÇËSHJET SOCIALE TË TRAJTUARA NGA SIPËRMARRJET SOCIALE (N=34)



Në përputhje me sa më sipër, çështja më e trajtuar nga sipërmarrjet sociale pjesë të studimit është punësimi i grupeve të margjinalizuara (58.8%), e ndjekur nga fuqizimi ekonomik (52.9%), mbrojtja sociale e grupeve të margjinalizuara dhe mbrojtja e mjedisit (38.2%). Trendi është shumë i ngjashëm me rezultatet e 2 viteve më parë. Përsëri, vihet re se sipërmarrjet sociale nuk trajtojnë çështje si sundimi i ligjit dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, por ka një interes të shtuar për sa i përket angazhimit qytetar, mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit.

GRAFIK 14: GRUPI MË I SHPESHTË I PËRFITUESVE TË CILËVE U SHËRBEJNË SIPËRMARRJET SOCIALE (N=34)




Ka një shtrirje më të gjerë të fokusit të SS-ve në lidhje me grupet e tyre përfituese nga viti 2020 në 2022. Grupi i përfituesve të cilëve SS-të u shërbejnë më shumë në vitin 2022 janë: gratë rurale (të shërbyera nga 91.2% e SS-ve), gratë që janë ose rrezikojnë të jenë viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje (të shërbyera nga 91.2% e SS-ve), rinia (të shërbyer nga 88.2% e SS-ve), publiku i gjerë (të shërbyer nga 88.2% e SS-ve), të papunët (të shërbyer nga 88.2% e SS-ve), studentët (të shërbyer nga 85.3% e SS-ve), njerëzit e varfër (të shërbyer nga 85.3% e SS-ve), OSHC-të (të shërbyer nga 85.3% e SS-ve).

Grupi i përfituesve që shërbehet më pak nga SS-të është ai i përdoruesve të drogës dhe alkoolit (të shërbyer nga 55.9%).

Në vitin 2020, grupet e përfituesve më të shërbyer nga sipërmarrjet sociale ishin: të papunët (të shërbyer nga 74% e SS-ve), të rinjtë (të shërbyer nga 74% e SS-ve), njerëzit e varfër (të shërbyer nga 69% e SS-ve) dhe studentët (të shërbyer nga 62% e SS-ve). Grupet e tjera të përfituesve u shërbyen nga 39% e SS-ve ose më pak.


**GRAFIK 15: PËRQINDJA E GRUPEVE TË MARGJINALIZUARA TË PUNËSUAR NGA SIPËRMARRJET SOCIALE (N=32)**



Analiza e të dhënave tregon se gjysma (**50%**) e sipërmarrjeve sociale kanë 30% dhe mbi 30% të totalit të punonjësve të tyre nga grupet e marginalizuara, ndjekur nga 28.1% e SS-ve që shprehin se deri në 29% e punonjësve të tyre i përkasin grupeve të marginalizuara, dhe 21.9% nuk kanë të punësuar persona nga grupet e marginalizuara. Situata është e ngjashme me 2 vjet më parë, por në 2022 numri i SS-ve që nuk punësojnë persona nga grupet e marginalizuara është më i lartë (nga 17% në 2020 në 21.9% në 2022).


Të anketuarit raportojnë se kanë integruar në sipërmarrjet e tyre sociale, gra dhe të rinj të papunë ose që jetojnë në zona rurale me mundësi të pakta, komunitet rom dhe egjiptian, persona me aftësi të kufizuara fizike ose të shëndetit mendor (intelektuale), persona me sindromën Down, viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje.

**GRAFIK 16: PËRQINDJA E GRUPEVE TË MARGJINALIZUARA TË PUNËSUAR NGA SIPËRMARRJET SOCIALE SIAPS FORMËS SË TYRE LIGJORE**



Shumica e subjekteve fitimprurëse (80%) përgjigjen se 30% dhe mbi 30% e punonjësve të tyre i përkasin grupeve të marginalizuara, ndërsa 44.4% e organizatave jofitimprurëse kanë 30% dhe mbi 30% punonjës nga grupet e marginalizuara. Këto të dhëna tregojnë se ekziston një potencial i papërdorur i organizatave fitimprurëse ose formave të tjera të sipërmarrjeve sociale që kanë në fokus integrimin në punë të grupeve të marginalizuara. Edhe pse këto organizata plotësojnë kriteret e ligjit Nr. 65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”, për të pasur 30% të punonjësve nga grupet e marginalizuara, ato përjashtohen nga përfitimi i statusit të ndërmarrjes sociale, për shkak të kufizimeve të ligjit, i cili lejon vetëm organizatat jofitimprurëse të aplikojnë dhe të marrin statusin e NS-së.

GRAFIK 17: NDËRMARRJA E NISMAVE SPECIFIKE PËR MIRËQËNIEN E PUNONJËSVE(N=34)




Nismat e ndërmarra më shpesh nga SS-të për të përmirësuar mirëqenien e punonjësve të tyre janë: sigurime shëndetësore shtesë (41,2% e SS-ve), **shërbime mbështetëse për familjet e punonjësve** (38% e SS-ve), **pagesa e tarifave të abonimit në transportin publik** (35,3% e SS-ve), ndërsa **ofrimi i bursave për fëmijët e punonjësve** nuk aplikohet asnjëherë nga 61.8% e SS-ve pjesëmarrëse në studim.

Krahasuar me vitin 2020, vihet re një rritje e ndjeshme e SS-ve që ofrojnë shpesh sigurime shëndetësore shtesë (nga 19% në 2020 në 41.2% në 2022), dhe pagesa të tarifave të abonimit të transportit publik (nga 19% in 2020 në 35.5% në 2022).

## DIMENSIONI EKONOMIK


Në këtë seksion rezultatet tregojnë karakteristikat ekonomike të sipërmarrjeve sociale në Shqipëri. Gjetjet kryesore janë të fokusuar në: produktet/shërbimet e ofruara ose të planifikuara, nivelin e përpjekjeve të SS-ve në aktivitete të ndryshme, burimet e të ardhurave të formave të ndryshme ligjore, metodat e prodhimit të produkteve/shërbimeve, format e shpërndarjes së fitimit.

GRAFIK 18: INDUSTRIA NË TË CILËN OPEROJNË SIPËRMARRJET SOCIALE (PËR SIPËRMARRJET SOCIALE TË THEMELUARA), OSE DËSHIROJNË TË OPEROJNË (PËR ATO QË PLANIFIKOJNË TË KRIJOJNË NJË SIPËRMARRJE SOCIALE) (N=34)




Vihet re se sipërmarrjet sociale që kanë marrë pjesë në studim nuk janë të fokusuar në një industri specifike. Shumica e tyre (20.6%) operojnë në industri të ndryshme, të tjera nga ato që paraqiten si alternativa në pyetësor, të tilla si zeytaria, peshkimi, punësimi i grupeve vulnerabël dhe shërbimi i hotelierisë. Nga alternativat e ofruara, industria më e përzgjedhur (në të cilën operojnë më shumë SS) është promovimi i turizmit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore (operojnë 17.6% e SS-ve), e ndjekur nga shërbimet në fushën e edukimit (operojnë 11.8% e SS-ve), ndërmjetësimi për punësim dhe mbrojtja e mjedisit të përzgjedhura nga 8.8% e SS-ve.

**GRAFIK 19: INDUSTRIA NË TË CILËN OPEROJNË SIPËRMARRJET SOCIALE (PËR SIPËRMARRJET SOCIALE TË THEMELUARA, OSE DËSHIROJNË TË OPEROJNË (PËR ATO QË PLANIFIKOJNË TË KRIJOJNË NJË SIPËRMARRJE SOCIALE), SIPAS FORMËS SË TYRE LIGJORE (N=34)**




Shumica e subjekteve fitimprurëse pjesë e studimit operojnë në industrinë e bujqësisë/blegtorisë (33.3%), ndjekur nga industria e mbrojtjes së mjedisit (16.7%), industria e ushqimit/pijeve (16.7%) dhe industria e promovimit të turizmit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore (16.7%). Përqendrimi në këto industri është më i lartë se në vitin 2020. Ndërsa, shumica e organizatave jofitimprurëse operojnë në industrinë e promovimit të turizmit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore (17.9%), ndjekur nga shërbimet në fushën e edukimit (14.3%) dhe ndërmjetësimi për punësim (10.7 %).

**GRAFIK 20: INDUSTRIA NË TË CILËN OPEROJNË SIPËRMARRJET SOCIALE, OSE DËSHIROJNË TË OPEROJNË SIPAS LLOJIT TË STRATEGJISË SË PËRDORUR (N=34)**




Sipërmarrjet sociale që operojnë në industri si: punësimi i të rinjve, shërbimet sociale, shitja me pakicë dhe ndërmjetësimi për punësim janë tërësisht të fokusuar në strategjinë e **integritit në punë**. **Tregtia e ndershme** është fokusi i të gjitha SS-ve që operojnë në bujqësi/blegtori, ushqim/pije dhe shumicës së SS-ve që operojnë në industrinë e prodhimit/përpunimit. Sipërmarrjet sociale që operojnë në industrinë e shërbimeve në fushën e edukimit, shëndetsisë dhe promovimit të turizmit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore në shumicën e rasteve kanë si më të preferuar strategjinë **fundi i piramidës**. Krahasuar me rezultatet e vitit 2020, situata është e ngjashme dhe nuk ka ndryshime të mëdha.

**GRAFIK 21: METODAT E PRODHIMIT DHE/ APO SIGURIMIT TË SHËRBIMEVE QË PËRSHKRUAJNË MË MIRË AKTIVITETIN E SIPËRMARRJES SOCIALE SIPAS FORMËS SË TYRE LIGJORE (N=34)**



Nga analiza e të dhënave rezulton se 83,3% e subjekteve fitimprurëse pjesëmarrëse në studim përdorin metodën e punës intensive dhe asnjëra prej tyre nuk përdor metodën e kapitalit intensiv. Ndërsa organizatat jofitimprurëse janë të orientuara drejt punës intensive në 46,4% të rasteve dhe kapitalit intensiv në 35,7 % të rasteve. Ka një ndryshim të konsiderueshëm në metodën e përdorur nga organizatat fitimprurëse në vitin 2022 krahasuar me atë të përdorur në studimin e mëparshëm. Në vitin 2020 rreth gjysma e tyre (47%) përdornin metodën e kapitalit intensiv.


**GRAFIK 22: METODAT E PRODHIMIT DHE/ APO SIGURIMIT TË SHËRBIMEVE QË PËRSHKRUAJNË MË MIRË AKTIVITETIN E SIPËRMARRJES SOCIALE SIPAS INDUSTRIËS NË TË CILËN ATO OPEROJNË(N=34)**






Sipërmarrjet sociale që ofrojnë ushqim/pije, shitje me pakicë, shërbime në fushën e edukimit, mbrojtje mjedisore dhe shërbime sociale priren të përdorin më shumë metodën e punës intensive. Kjo është për shkak se industria e shërbimeve mbështetet më së shumti në fuqinë punëtore dhe jo në automatizimin dhe investimet në infrastrukturë. Në industrinë e promovimit të turizmit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore dhe prodhimit/përpunimit, metodat e punës **intensive** dhe kapitalit intensiv përdoren të dyja në të njëjtin nivel.

FIGURA 7: AKTIVITETET NË TË CILAT SIPËRMARRJET SOCIALE BËJNË PËRPFJEJE TË NIVELIT TË LARTË PËR TU PËRFSHIRË (N=34)




Rezultatet tregojnë se pesë aktivitetet në të cilat sipërmarrjet sociale bëjnë përpjekje të larta për tu përfshirë gjatë funksionimit të tyre janë: aktivitetet edukative (61,76%), këshillimi/konsulenca (55,88%), rrjetëzimi (52,94%), trajnimi (52,94%) dhe organizimi i aktiviteteve (50%). Krahasuar me vitin 2020, këshillimi/konsulenca është bërë një aktivitet i rëndësishëm për SS-të, për të cilin ato bëjnë përpjekje të nivelit të lartë (në vitin 2020 ky aktivitet nuk përfshihej në listën e aktiviteteve për të cilat SS-të bënin përpjekje të larta). Aktivitetet e tjera mbeten të njëjta.

GRAFIKU 23: BURIMET E TË ARDHURAVE E SUBJEKTEVE FITIMPRURËSE (N=6)




Vetëm tre nga alternativat e ofruara janë përzgjedhur si burime nga të cilat subjektet fitimprurëse gjenerojnë **shumë** të ardhura, përkatësisht shitjet (50% e SS-ve fitimprurëse), grantet (33% e SS-ve fitimprurëse) dhe huatë (17% e SS-ve fitimprurëse). **Kuotat e antarësisë, skemat e investimeve dhe prokurimet publike** janë ndër burimet e të ardhurave nga të cilat shumica e SS-ve nuk gjenerojnë të ardhura. Situata është pothuajse e njëjtë me subvencionet shtetërore dhe investitorët/engjëjt e biznesit, nga të cilat 50% e SS-ve pjesëmarrëse gjenerojnë të ardhura të ulëta-mesatare dhe gjysma tjetër e SS-ve nuk gjenerojnë aspak të ardhura nga këto burime.

GRAFIK 24: BURIMET E TË ARDHURAVE TË ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE (N=27)



Organizatat jo-fitimprurëse mbështeten kryesisht në **grante**, të ndjekura nga **kuotat e antarësisë** dhe **shitjet**. Shumica prej tyre nuk merr pothuajse asnjë mbështetje nga kreditë, investitorët/ engjëjt e biznesit, skemat e investimeve, prokurimet publike dhe subvencionet shtetërore. Kjo rikonfirmon faktin se organizatat jo-fitimprurëse vazhdojnë të vuajnë nga mungesa e burimeve të ndryshme të të ardhurave.

GRAFIK 25: FORMAT E SHPËRNDARJES SË FITIMEVE /TË ARDHURAVE (N=34)




Format kryesorë të shpërndarjes së fitimit/të ardhurave janë: **shtim të numrit të punonjësve** (64,7%), **blerja e pajisjeve të reja** (61,8%), **financimi i projekteve të reja** (58,8%), **kryerja e kërkimeve (hulumtime, sondazhe) për zhvillim** (58,8%), **pagesa për reklamim** (58,8%), dhe **shpenzime për strategjitë të reja të marketingut** (58,8%). **Pagesa e dividendëve** vazhdon të jetë forma e shpërndarjes së fitimit që përdoret **më pak** nga sipërmarrjet sociale. Kjo ndodh për arsye se të ardhurat e tyre nuk janë mjaftueshëm domethënëse, si dhe organizatat që kanë veprimtari të sipërmarrjes sociale respektojnë parimin e mosshpërndarjes së fitimit, dhe kuadrin ligjor mbi organizatat jo-fitimprurëse (të cilat përfaqësojnë formën ligjore të numrit më të madh të sipërmarrjeve sociale pjesëmarrëse në studim).

## STRUKTURA E QEVERISJES

Në këtë pjesë, të dhënat tregojnë strukturën vendimmarrëse të pjesëmarrësve në studim.

GRAFIK 26: PËRBËRJA E STRUKTURËS VENDIMMARRËSE (N=34)



Për sa i përket strukturës qeverisëse, shumica e sipërmarrjeve sociale që morën pjesë në studim kanë një strukturë qeverisëse me pjesëmarrje. Rreth 73.5% e SS-ve përfshijnë **punonjësit** si pjesë e strukturës së tyre vendimmarrëse, e ndjekur nga 47.1% që përfshijnë **përfituesit** e tyre, 35.3% që përfshijnë **vullnetarë** dhe 23.5% e SS-ve raportojnë se përfshijnë përdoruesit e shërbimeve dhe konsumatorët e produkteve të tyre. Pushteti vendor nuk është një aktor i rëndësishëm i përfshirë në strukturat vendimmarrëse të sipërmarrjeve sociale.

## SFIDAT DHE NEVOJAT E IDENTIFIKUARA NGA SIPËRMARRJET SOCIALE

Në këtë pjesë paraqiten gjetjet mbi sfidat me të cilat përballen sipërmarrjet sociale të themeluara dhe potenciale, si dhe nevojat e tyre për t'u rritur në mënyrë të qëndrueshme. Gjithashtu në këtë seksion është paraqitur dhe qasja e sipërmarrjeve sociale të anketuara ndaj kuadrit aktual ligjor dhe trajtimit tatimor/fiskal.


GRAFIK 27: SFIDAT QË PENGOJNË NË RRIJTJEN E SIPËRMARRJEVE SOCIALE (N=34)



SS-të u pyetën në lidhje me disa sfida specifike që mund të pengonin rritjen e tyre. Nga përgjigjet rezultojnë se më shumë se gjysma e kampionit i konsideron të gjitha sfidat e listuara si penguese për rritjen dhe zhvillimin e tyre. Pothuajse të gjithë kanë përzgjedhur **mungesën e financimit** (94.1%) si sfidën kryesore, të ndjekur nga **rekrutimi i punonjësve** (76.5%) dhe **nivel i ulët i ndërgjegjësimit të investitorëve** (76.5%). Krahasuar me studimin e vitit 2020, në vitin 2022 ka një rritje të lehtë të SS-ve që i konsiderojnë sfidat e paraqitura si penguese.

Organizatrat fitimprurëse konsiderojnë veçanërisht penguese **mungesën e financimit, bindjen e klientëve për të blerë produktet e tyre kundrejt markave të tjera, dhe rekrutimin e punonjësve**, ndërsa organizatat jo-fitimprurëse kryesisht konsiderojnë penguese: **mungesën e financimit dhe ndërgjegjësimin e ulët të investitorëve**.

GRAFIK 28: NDIKIMI I KUADRI LIGJOR AKTUAL DHE TRAJTIMIT TATIMOR/FISKAL NË ZHVILLIMIN E SIPËRMARRJEVE SOCIALE (N=34)



Vlen për tu theksuar se shumica e SS-ve pjesëmarrëse në studim nuk janë në dijeni të ndikimit që ka trajtimi tatimor/fiskal dhe kuadri ligjor në zhvillimin e veprimtarisë së tyre. Vetëm 20.6% e SS-ve vlerësojnë se kuadri ligjor aktual ka ndikuar pozitivisht, ndërsa 17.6% e tyre mendojnë se ka ndikuar negativisht. Nga ana tjetër, shumë pak SS, vetëm 8.8% e tyre konsiderojnë se zhvillimi i tyre ndikohet pozitivisht nga trajtimi tatimor/fiskal, ndërsa 29.4% e tyre vlerësojnë se trajtimi tatimor/fiskal ka ndikuar negativisht në zhvillimin e tyre.

Ndërkohë, 2 nga 3 sipërmarrjet sociale që kanë marrë pjesë në studim dhe kanë marrë statusin e NS-së, janë shprehur se nuk janë në dijeni të ndikimit të kuadrit ligjor në zhvillimin e NS-së së tyre dhe asnjëra prej tyre nuk e vlerësoi pozitivisht ndikimin e trajtimit tatimor/fiskal.

Disa nga opinionet e të anketuarve mbi kuadrin ligjor janë:

“Nuk ka politika të favorshme, p.sh. heqja e taksave vjetore”.

“Kuadri ligjor nuk ofron mbështetje të mjaftueshme për zhvillimin e ndërmarrjeve sociale”

“Përfaqësuesit e shtetit janë të korruptuar dhe shpesh kërkojnë para për aplikimin dhe lëshimin e licencave të reja, edhe kur produktet janë në standardet më të larta.”

“Sistemi ligjor fiskal është i njëjtë për një biznes normal dhe një sipërmarrje sociale (biznes me impakt social). Nuk stimulon apo inkurajon.”


Disa nga qëndrimet e pjesëmarrësve në studim lidhje me trajtimin tatimor/fiskal janë:

“Trajtimi fiskal ul të ardhurat e sipërmarrjeve sociale”.

“Trajtimi fiskal duhet të jetë më mbështetës dhe lehtësues për NS-të.”


“Trajtimi fiskal për sipërmarrjet sociale nuk ofron trajtim të ndryshëm nga organizatat apo kompanitë e tjera tregtare”.

GRAFIK 29: NJOHURIA E PJESËMARRËSEVE NË STUDIM MBI KUADRIN LIGJOR TË NDËRMARRJEVE SOCIALE (N=33)




Pjesëmarrësit në studim u pyetën nëse janë të informuar dhe në dijeni për Ligjin nr. 65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë. Është pozitive që shumica e tyre e njohin ligjin, edhe pse në nivele të ndryshme kuptimi. Shumica e të anketuarve (42.4%) deklarojnë se e njohin ligjin mirë ose shumë mirë, 45.4% kanë njohuri të pjesshme të ligjit, ndërsa pjesa tjetër nuk e njohin aspak. Vërehet një ndryshim pozitiv krahasuar me vitin 2020, ku 45% e të anketuarve kishin pak ose aspak njohuri mbi ligjin. Duket se përpjekjet e bëra nga organizatat e sektorit për ndërgjegjësim kanë dhënë rezultat.

GRAFIK 30: PLANI I SIPËRMARRJEVE SOCIALE PËR TË APLIKUAR PËR STATUSIN E NDËRMARRJES SOCIALE(N=32)



Shumica e të anketuarve (40%) nuk janë të sigurt nëse do të aplikojnë për statusin e ndërmarrjes sociale apo jo, ndërsa ka një përqindje të barabartë të atyre që planifikojnë të aplikojnë për statusin e ndërmarrjes sociale dhe atyre që nuk planifikojnë të aplikojnë (30%). Situata është pothuajse e njëjtë me vitin 2020, me një rënie të vogël në përqindjen së atyre që do të aplikonin për statusin (37,5% në 2020).

GRAFIK 31: APLIKIMI PËR PËRFITIMIN E STATUSIT TË NDËRMARRJES SOCIALE SIPAS NJOHURIVE MBI KUADRIN LIGJOR (N=30)



Të gjitha SS-të që nuk janë në dijeni të kuadrin ligjor mendojnë pozitivisht për aplikimin për statusin e NS-së (50% ndoshta dhe 50% po). Nga ana tjetër, vihet re se 35% e atyre që njohin kuadrin ligjor nuk mendojnë të aplikojnë për statusin. Kjo evidencë tregon se konsiderata për të aplikuar për statusin e ndërmarrjes sociale është më e ulët tek ato SS që njohin kuadrin ligjor dhe janë të vetëdijshëm për problematikat e tij.

# KONKLUZIONE

Më poshtë janë paraqitur përfundimet e studimit bazuar në analizën e të dhënave:

## KARAKTERISTIKAT E SIPËRMARRJEVE SOCIALE

- Ky studim përforcon edhe një herë gjetjet e raporteve të mëparshme se sipërmarrjet sociale në Shqipëri janë një **fenomen relativisht ri**, të përhapura kryesisht dy dekadadat e fundit. Shumica e sipërmarrjeve sociale e kanë filluar aktivitetin e tyre duke u regjistruar si **organizata jo-fitimprurëse**, por ekosistemi përfshin edhe forma të tjera ligjore si **subjektet fitimprurëse** (biznes, person fizik/juridik). Shumica e sipërmarrjeve sociale janë krijuar gjatë dekadës së fundit dhe ndodhen në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë.
- Shumica e sipërmarrjeve sociale në studim kanë **1-5 punonjës me kohë të plotë**. Ky fakt nuk ka ndryshuar që nga studimi i kryer 6 vite më parë (Partnerët Shqipëri, 2016). Vazhdon të jetë e vështirë për sipërmarrjet sociale të rrisin kapacitetet dhe fuqinë punëtore ndërkohë që burimet e të ardhurave të tyre nuk janë të shumta dhe të ndryshme, si dhe operojnë në një mjedis biznesi pa stimuj fiskalë. Situata është përkeqësuar në krahasim me vitin 2020 dhe COVID-19 mund të ketë qenë një arsye tjetër që ka penguar zhvillimin e SS-ve. Sipërmarrjet sociale në Shqipëri përfshijnë vullnetarë dhe në shumicën e rasteve kanë **1-10 vullnetarë**.
- Sipërmarrjet sociale në Shqipëri aplikojnë **katër strategji kryesore**: integrimi në punë, tregtia e ndershme, fundi i piramidës dhe inovacionin social. **Dy** strategjitë më të përdorura nga SS-të janë **integrimi në punë i grupeve të marginalizuara** dhe **strategjia e tregtisë së ndershme**. Ekziston një korrelacion ndërmjet strategjisë së përdorur nga sipërmarrjet sociale dhe formës së tyre ligjore. Subjektet fitimprurëse kryesisht përdorin **strategjinë e tregtisë së ndershme**, ndërsa në organizatat jo-fitimprurëse mbizotëron **strategjia e integritit në punë**.

# DIMENSIONI SOCIAL I SIPËRMARRJEVE SOCIALE

- Sipërmarrjet sociale kanë në fokusin e tyre më shumë **qëllimin social** sesa atë ekonomik. Ekziston një korrelacion midis qëllimit të sipërmarrjes sociale dhe formës së tyre ligjore. Subjektet fitimprurëse ndjekin **kryesisht qëllimin ekonomik**, ndërsa organizatat jo-fitimprurëse ndjekin **kryesisht qëllimin social**. Megjithatë, vihet re një tendencë në rritje e orientimit të subjekteve fitimprurëse drejt qëllimit social krahas qëllimit ekonomik.
- **30% dhe mbi 30%** e të punësuarve në shumicën e sipërmarrjeve sociale vijnë nga grupet e marginalizuara, duke qenë kështu në përputhje me kërkesat e ligjit për ndërmarrjet sociale, në lidhje me punësimin e grupeve të marginalizuara.
- Sipërmarrjet sociale në Shqipëri, ndërmarrin nisma specifike për mirëqenien e punonjësve të tyre, kryesisht **sigurime shëndetësore shtesë dhe shërbime mbështetëse për familjet e tyre**.
- Grupet e përfituesve të cilëve sipërmarrjet sociale u shërbejnë vazhdimisht janë: **gratë në zonat rurale, gratë që janë ose rrezikojnë të jenë viktime të trafikimit apo dhunës, të rinjtë, publiku i gjerë dhe të papunët**. Sipërmarrjet sociale u shërbejnë këtyre përfituesve në mënyra të ndryshme. Disa prej tyre i marrin shërbimet falas ose me çmim më të ulët se klientët e tjerë. Ndërkohë, disa sipërmarrje sociale përdorin fitimin e gjeneruar nga aktiviteti ekonomik **për t'i shërbyer më mirë dhe në shkallë më të madhe** këtyre përfituesve si pjesë e misionit të tyre, ashtu siç ndodh në shumë vende të BE-së.
- Çështjet sociale më të adresuara nga sipërmarrjet sociale janë: **punësimi i grupeve të marginalizuara, fuqizimi ekonomik, mbrojtja sociale e grupeve të marginalizuara, mbrojtja e mjedisit dhe arsimit**. Sipërmarrjet sociale nuk trajtojnë çështje të tilla si sundimi i ligjit dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, por ka një interes të shtuar për angazhimin qytetar.



# DIMENSIONI EKONOMIK I SIPËRMARRJEVE SOCIALE

- Sipërmarrjet sociale operojnë në industri të ndryshme si: **artizanati, peshkimi, promovimi i turizmit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore dhe shërbime në fushën e edukimit.**
- Metodat e prodhimit dhe/apo sigurimit të shërbimeve të përdorura nga sipërmarrjet sociale janë kryesisht dy metodat: metoda e prodhimit me kapital intensiv dhe metoda e punës intensive. Nuk ka korrelacion midis formës ligjore të SS-ve dhe metodës së prodhimit dhe/apo sigurimit të shërbimeve që ato përdorin. Shumica e subjekteve fitimprurëse përdorin metodën e punës intensive dhe asnjëra prej tyre nuk përdor metodën e prodhimit me kapital intensiv. Organizatat jofitimprurëse aplikojnë të dyja metodat, por kryesisht janë të orientuara drejt metodës së punës intensive. Të gjitha format e SS-ve kanë kthyer fokusin e tyre drejt zgjerimit të kapaciteteve njerëzore/metodës së punës intensive, ndoshta për shkak të investimeve më të vogla në krahasim me metodën e kapitalit intensiv.
- Rezultatet tregojnë se pesë aktivitetet në të cilat sipërmarrjet sociale bëjnë përpjekje të larta gjatë funksionimit të tyre janë: aktivitetet edukative, këshillimi/konsulenca, rrjetëzimi, trajnimi dhe organizimi i aktiviteteve.
- Burimet e të ardhurave, e të gjitha formave të sipërmarrjeve sociale janë të pakta, dhe të limituara në: shitjet, grantet dhe kuotat e anëtarësisë (të aplikueshme vetëm për shoqatat). **Shitjet** përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave për entitetet fitimprurëse, ndërsa organizatat jo-fitimprurëse mbështeten kryesisht në grante. Forma të tjera alternative të burimeve të të ardhurave prezentë në vende të tjera si: **investitorët-engjëjt e biznesit, subvencionet shtetërore, skemat e investimit dhe prokurimet publike**, mungojnë në ekosistemin e sipërmarrjeve sociale shqiptare. Mbijetesa në treg bëhet më e vështirë për sipërmarrjet sociale nëse nuk diversifikojnë burimet e të ardhurave, edhe pse diversifikimi i burimeve është i vështirë në rast të subvencioneve shtetërore dhe prokurimeve publike, nëse ato nuk ofrohen nga institucionet përkatëse.
- Për sa i përket fitimit, shumë pak sipërmarrje sociale arrijnë të gjenerojnë fitim nga shitja e produkteve/shërbimeve të tyre. Format më të zakonshme të shpërndarjes të fitimit nga sipërmarrjet sociale janë: **shtimi i numrit të punonjësve, blerja e pajisjeve të reja; financimi i projekteve të reja; kryerja e kërkimeve (hulumtime dhe sondazhe) për zhvillim; pagesa për reklamim dhe zbatim i strategjive të reja të marketingut.** Ligji Nr. 65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë” nuk lejon shpërndarjen e asnjë lloji fitimi, edhe pse në vende të tjera njihet me ligj mundësia për shpërndarjen e një përqindje të caktuar të fitimit te/për sipërmarrësit social (Partnerët Shqipëri, 2019).

# DIMENSIONI STRUKTURA E QEVERISJES E SIPËRMARRJEVE SOCIALE

Sipërmarrjet sociale përqipen të kenë një strukturë qeverisëse me pjesëmarrje, nëpërmjet pjesëmarrjes së: **punonjësve, përfituesve, vullnetarëve dhe përdoruesve të shërbimeve/blerësve të produkteve.** Kategoria që përfshihet më së shumti në strukturat vendimmarrëse të organizatave jo-fitimprurëse janë punonjësit. Ndërsa, pushteti vendor nuk është i përfshirë në strukturat vendimmarrëse të sipërmarrjeve sociale.

# SFIDAT DHE NEVOJAT E SIPËRMARRJEVE SOCIALE

- Aksesi në financa vazhdon që të jetë sfida kryesore e sipërmarrjeve sociale në Shqipëri, i ndjekur nga **rekrutimi i punonjësve** dhe **niveli i ulët i ndërgjegjësimit të investitorëve**. Këto sfida të sektorit janë të pranishme edhe në Evropë. Për shkak të natyrës specifike të sektorit, përfituesve që u shërbejnë dhe misionit social të SS-ve, investitorët i konsiderojnë sipërmarrjet sociale si investime me rrezik të lartë të shoqëruara me një normë më të ulët kthimi.
- Shumica e sipërmarrjeve sociale e konsiderojnë trajtimin tatimor/fiskal dhe kuadrin ligjor aktual si sfida, të cilat po ndikojnë **negativisht** në zhvillimin e sektorit ose nuk kanë fare ndikim. Mungesa e iniciativave fiskale edhe për sipërmarrjet sociale që punësojnë grupe të marginalizuara, e shoqëruar me paqartësi dhe kufizimet e kuadrin ligjor në fuqi, vendosin një pikëpyetje të madhe në zhvillimin e sipërmarrjeve sociale në vend.
- Ka një **përmirësim dhe rritje të njohurive** të sipërmarrjeve sociale mbi kuadrin ligjor në fuqi, por kjo e shoqëruar me një hezitim më të lartë të sipërmarrjeve për të aplikuar për përfitimin e statusit të ndërmarrës sociale.

## DALLIMET KRYESORE: 2020 VS 2022

- Në terma të përgjithshëm situata e sipërmarrjeve sociale në Shqipëri nuk ka ndryshuar shumë nga viti 2020 deri në vitin 2022. Sipërmarrjet sociale vazhdojnë të kenë të njëjtat sfida dhe problematika. Sipërmarrësit social vazhdojnë të kenë të njëjtin nivel besimi në lidhje me mundësinë e tyre për të sjellë një ndikim të rëndësishëm shoqëror. Ndërkohë besimi i sipërmarrësve social shqiptar ndaj investitorëve dhe mbështetësve të komunitetit është ulur ndjeshëm.
- Numri i punonjësve me kohë të plotë në SS-të është zvogëluar, ndërsa numri i vullnetarëve është rritur. Gjithashtu, është rritur numri i SS-ve që nuk punësojnë persona nga grupet e marginalizuara.
- Për sa i përket qëllimit, pothuajse të gjitha format e SS-ve kanë filluar të orientohen drejt qëllimit social, duke përfshirë këtu një numër të konsiderueshëm subjektsh fitimprurëse. Strategjia e SS-ve gjithashtu ka ndryshuar, ku më shumë prej tyre janë të fokusuar në integrimin e punës dhe më pak në tregtinë e ndershme.
- Vihet re një rritje e ndjeshme e SS-ve që vazhdimisht ofrojnë sigurime shëndetësore shtesë dhe mbulim të tarifës së abonimit të transportit publik, si një nismë e SS-ve për rritjen e mirëqenies së punonjësve të tyre.
- SS-të në vitin 2022 kanë treguar një nivel të lartë përpjekjesh për tu përfshirë në aktivitete si këshillimi/konsulenca.
- Vihet re një ndryshim pozitiv për sa i përket nivelit të njohurive të SS-ve mbi ligjin e ndërmarrjeve sociale. Por numri i SS-ve që kanë shprehur se do të aplikojnë për statusin e ndërmarrjes sociale është ulur.

# REKOMANDIME

Bazuar në rezultatet dhe gjetjet e nxjerra nga hulumtimi, janë ngritur nga autorët disa supozime dhe rekomandime që duhen marrë parasysh nga sipërmarrjet sociale dhe politikëbërësit shqiptarë gjatë hartimit dhe rishikimit të strategjive, politikave dhe programeve të tyre për sipërmarrjen sociale. Këto rekomandime dhe supozime janë renditur më poshtë.

## PËRMIRËSIMI I MJEDISIT LIGJOR DHE POLITIKËBËRËS TË SS-VE NË SHQIPËRI

- Është shumë e rëndësishme që Qeveria e Shqipërisë të identifikojë prioritetet strategjike dhe të hartojë strategji të koordinuara ndërsektoriale të qarta që mbështesin organizata të llojeve, madhësive dhe industrive të ndryshme.
- Qeveria e Shqipërisë duhet të bashkëpunojë me organizatat mbështetëse të sipërmarrjeve sociale në Shqipëri dhe me përfaqësues të SS-ve, duke organizuar takime të vazhdueshme, tryeza, grupe pune, sesione informative për të rritur më tej ndërgjegjësimin dhe hartimin e politikave, strategjive, nismave dhe aktiviteteve të përbashkëta.
- Qeveria e Shqipërisë duhet të rishqyrtojë kuadrin fiskal dhe tatimor për sipërmarrjet sociale. Rekomandohen të aplikohen dhe ndërmerren iniciativa të ndryshme tatimore dhe taksash për sipërmarrjet e reja sociale.
- Ligji Shqiptar për ndërmarrjet sociale duhet të amendohet për të adresuar të gjitha sfidat e identifikuar dhe paraqitura pranë autoriteteve përkatëse. (Partnerët Shqiptarë, 2022)

## IDENTIFIKIMI DHE KRIJIMI I MUNDËSIVE TË REJA, TË NDRYSHME FINANCIMI PËR SIPËRMARRJET SOCIALE NË SHQIPËRI

- Gjetjet tregojnë se sipërmarrjet sociale kanë burime të vogla të të ardhurave, përballën me sfida në aksesin e fondeve dhe regjistrojnë nivele të ulëta fitimesh. Duke marrë parasysh përvojën ndërkombëtare ku SS-të varen shumë nga kontratat publike dhe mbështetja shtetërore, pushteti vendor duhet të prokurojë shërbimet sociale nëpërmjet SS-ve dhe të ndërtojë partneritete të drejtpërdrejta për shërbime specifike.
- Shteti duhet të stimulojë dhe të mbështesë të gjitha SS-të dhe në veçanti sipërmarrjet sociale me në fokus integrimin në punë me subvencione për punonjësit, ulje të TVSH-së dhe përjashtim nga tatimi mbi fitimin. Praktikrat e mira ndërkombëtare ofrojnë iniciativa të shumta fiskale për të stimuluar aktivitetin e sipërmarrjeve sociale.
- Autoritetet kombëtare financiare dhe fiskale duhet të krijojnë paketa të dedikuara dhe përfitime për SS-të, p.sh. mikrokredi, komisione më të ulëta, më shumë akses në skemat e investimeve, etj.

- Ligji i ri për startup-et “Për Mbështetjen dhe Zhvillimin e STARTUP-EVE” (Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, 2022) duhet të marrë në konsideratë edhe sipërmarrjet sociale, duke pasur një fokus dhe fond të dedikuar për startup-et që janë të orientuar drejt inovacionit social.
- Organizatat mbështetëse këshillohen të vazhdojnë punën e tyre për ndërtimin e urave të bashkëpunimit me organizatat e huaja për shkëmbimin e eksperiencës, rrjetëzimin dhe krijimin e mundësive për financimin e sipërmarrjeve sociale shqiptare.
- Duhet të rritet më shumë ndërgjegjësimi i investitorëve dhe engjëjve të biznesit vendas, në lidhje me ekzistencën dhe potencialin e SS-ve.

## NGRITJA E KAPACITETEVE DHE EDUKIMI I SIPËRMARRJEVE SOCIALE NË SHQIPËRI

- Duke pasur parasysh nevojën për një edukim të cilësisë së lartë në fushën e sipërmarrjes sociale, programet e trajnimit të organizatave mbështetëse të SS-ve duhet të trajtojnë në veçanti tema të tilla si aftësia për të identifikuar mundësitë e reja në treg, kërkimi i tregut, marrëdhëniet me publikun dhe komunikimi, menaxhimi financiar, zgjidhja e problemeve, ndërtimi i planit të biznesit, shitjet, menaxhimi i rrezikut, sipërmarrja sociale, inovacioni social, SDG-të dhe qëndrueshmëria.
- Programet e trajnimit duhet të hartohen si paketa të plota të ofruara në një mënyrë inovative dhe duke përfshirë seminare, mentorim, detyra praktike, trajnim, rrjetëzim dhe mundësi financimi, projekte, etj.
- Duhet të organizohen më shumë aktivitete ndërsektoriale ndërmjet donatorëve, sipërmarrjeve sociale, bizneseve dhe institucioneve publike me qëllimin kryesor zgjerimin e mundësive për investime konkrete në sektorin e SS-ve.

# REFERENCAT

- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (2016). Ligji Nr.65/2016 Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë.
- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (2022, 10 Mars). Ligji Nr. 25/2022 Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve. Tiranë, Shqipëri: Gazeta e Qeverisë.
- Borzaga, C., Poledrini, S., & Galera, G. (2017). Social Enterprise in Italy: Typology, Diffusion and Characteristics. Euricse Working Papers, 96(17). Përshtatur nga: [https://papers.ssrn.com/sol3/Delivery.cfm/SSRN\\_ID3036384\\_code515373.pdf?abstractid=3036384&mirid=1](https://papers.ssrn.com/sol3/Delivery.cfm/SSRN_ID3036384_code515373.pdf?abstractid=3036384&mirid=1)
- Defourny, J., & Nyssens, M. (2012). The EMES approach of social enterprise in a comparative perspective. Brussels, Belgium: EMES European Research Network. Përshtatur nga: [http://www.emes.net/site/wp-content/uploads/EMES-WP-12-03\\_Defourny-Nyssens.pdf](http://www.emes.net/site/wp-content/uploads/EMES-WP-12-03_Defourny-Nyssens.pdf)
- Erila Haska, J. H. (2020). Characteristics and Challenges of Social Enterprises in Albania. Tiranë.
- Euclid Network. (2021). The State of Social Enterprise Support in Europe and Neighbouring Countries, Annual Consultation 2020-2021. Hague: Euclid Network.
- Komisioni Evropian. (2011). COM(2011) 682 final Creating a favourable climate for social enterprises, key stakeholders in the social economy and innovation. Përshtatur nga: <https://www.fi-compass.eu/sites/default/files/publications/social-business-initiative-creating-a-favourable-climate-for-social-enterprises-key-stakeholders-in-the-social-economy-and-innovation.pdf>
- Komisioni Evropian. (2014). A map of social enterprises and their eco-systems in Europe. Country Report: Croatia. Përshtatur nga: <https://ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=12991&langId=en>
- Komisioni Evropian. (2014). A map of social enterprises and their eco-systems in Europe. Country Report: Greece. Përshtatur nga: <https://ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=13303&langId=en>
- Komisioni Evropian. (2015). A map of social enterprises and their eco-systems in Europe. Luxembourg: European Commission.
- Komisioni Evropian. (2017). Social Enterprises and their Eco-systems: Developments in Europe. Përshtatur nga: <https://ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=16376&langId=en>
- Komisioni Evropian. (2019). Social enterprises and their ecosystems in Europe. Country fiche: Albania. Authors: Ariola Agolli, Erila Haska, Juliana Hoxha. Luxembourg: Publications Office of the European Union. Përshtatur nga: <https://europa.eu/!Qq64ny>
- Komisioni Evropian. (2020). Social enterprises and their ecosystems in Europe. Comparative synthesis report. Author: Carlo Borzaga, Giulia Galera, Barbara Franchini, Stefania Chiomento, Rocio Nogales and Chiara Carini. Luxembourg: Publication Office of the European Union. Përshtatur nga: <https://europa.eu/!Qq64ny>
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2019, May 6). Aplikimi për përfitimin e statusit të Ndërmarrjes Sociale. Përshtatur nga: <https://shendetesia.gov.al/apliko-per-statusin-e-ndermarrjes-sociale/>
- Nyssens, M. (2006). Social Enterprise, At the Crossroads of Market, Public Policies and Civil Society. Routledge.
- OECD. (2022). Social entrepreneurship & Social enterprises. Përshtatur nga OECD: <https://www.oecd.org/cfe/leed/social-economy/social-entrepreneurship.htm>
- Partnerët Shqipëri. (2016). Sfidat dhe mundësitë për punësimin e grupeve të marxhinalizuara nga ndërmarrjet sociale. Autorët: Ariola Agolli, Erila Haska, Klotilda Tavani. Përshtatur nga: [https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2016/08/study\\_employment\\_marginalized\\_groups\\_by\\_SE.pdf](https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2016/08/study_employment_marginalized_groups_by_SE.pdf)
- Partnerët Shqipëri. (2019). Analiza e kuadrit Ligjor për Ndërmarrjet Sociale në Shqipëri. Autorët: Erila Haska, Juliana Hoxha. Përshtatur nga: <https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/07/Analyses-of-legal-framework-on-social-enterprises-in-Albania.pdf>
- Partnerët Shqipëri. (2022). Statusi i Ndërmarrjes Sociale: Sfidat dhe mundësitë për ndryshim. Tiranë
- Salatino, G. (2018). A spotlight on Italy: "The New Regulation of the "Social Enterprise" . Përshtatur nga: The Philanthropist: <https://thephilanthropist.ca/2018/08/a-spotlight-on-italy-the-new-regulation-of-the-social-enterprise/>
- Traversi, M. (2019). The Italian Eco-system for social enterprises. Përshtatur nga: <http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2019/08/THE-ITALIAN-ECOSYSTEM-FOR-SOCIAL-ENTERPRISES.pdf>

